

VENDIM
Nr. 16, datë 21.1.2000

**PËR BASHKIMIN E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MBRETËRINË
E BELGJIKËS DHE NË DUKATIN E MADH TË LUKSEMBURGUT DHE TË MISIONIT TË
PËRHERSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 8370, datë 9.7.1998, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Riorganizimin e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe në Dukatin e Madh të Luksemburgut dhe të Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit European.

2. Miratimin e bashkimit të ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe në Dukatin e Madh të Luksemburgut dhe të Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit European, të quajtur "Përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit European, në Mbretërinë e Belgjikës dhe në Dukatin e Madh të Luksemburgut".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta